

VENDIM
Nr. 130, datë 10.2.2026

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT TË NDIHMËS
SHTETËRORE NR. 99, DATË 16.10.2020, “AUTORIZIM I NDIHMËS
SHTETËRORE ‘MBËSHTETJE FINANCIARE (GRANT) PËR BIZNESE TË REJA
‘TË GJELBËRTA’, TË CILAT BAZOHEN NË NJË MODEL EKO-MIQËSOR, OSE
BIZNESE EKZISTUESE TË CILAT TENTOJNË TË SHNDËRROHEN NË BIZNESE
‘TË GJELBËRTA’ DUKE FUTUR ELEMENTE GO-GREEN NË TO”, I
NDRYSHUAR**

Komisioni i Ndihmës Shtetërore me pjesëmarrjen e:

- znj. Delina Ibrahimaj kryetare;
- znj. Mimoza Dhëmbi anëtare
- z. Besnik Çina anëtar;
- znj. Keida Qirko anëtare;
- z. Ahmet Mançellari anëtar,

në mbledhjen e tij të radhës të datës 10.2.2026, në Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit, në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005, “Për miratimin e rregullores ‘Për procedurat dhe formën e njoftimit’”, mori në shqyrtim kërkesën e Bashkisë Tiranë me shkresën nr. 2870, datë 20.1.2026, “Kërkesë për miratim të Autorizimit të Ndihmës Shtetërore për projektin e Bashkisë Tiranë ‘Mbështetje financiare (grant) për biznese të reja ‘të gjelbërta’, të cilat bazohen në një model eko-miqësor ose biznese ekzistuese të cilat tentojnë të shndërrohen në biznese ‘të gjelbërta’, për vitet 2026–2028”.

Baza ligjore për njoftimin e ndihmës: Vendimi i Këshillit Bashkiak Tiranë nr. 100, datë 18.12.2025, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2026–2028 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2026”.

Komisioni shqyrtoi planin e ndihmës shtetërore të sipërcituar, duke vlerësuar përputhshmërinë me ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, dhe:

VËREN SE:

1. Bashkia e Tiranës, me shkresën nr. 2870, datë 20.1.2026, ka kërkuar Autorizimin e Ndihmës Shtetërore për projektin e Bashkisë Tiranë “Mbështetje financiare (grant) për biznese të reja ‘të gjelbërta’, të cilat bazohen në një model eko-miqësor ose biznese ekzistuese të cilat tentojnë të shndërrohen në biznese ‘të gjelbërta’, për vitet 2026–2028, të shoqëruar me formularin e njoftimit”.

2. Në bazë të vendimit të Këshillit Bashkiak Tiranë nr. 100, datë 18.12.2025, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2026–2028 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2026”, në programin 04130 “Mbështetja për zhvillimin ekonomik”, projekti “Mbështetje financiare (grant) për biznese të reja ‘të gjelbërta’, të cilat bazohen në një model eko-miqësor ose biznese ekzistuese të cilat tentojnë të shndërrohen në biznese ‘të gjelbërta’, për vitet 2026–2028”, është miratuar vazhdimi i zbatimit të skemës ekzistuese për vitet 2026–2028, me kosto gjithsej 75.000.000 (shtatëdhjetë e pesë milionë lekë dhe plan vjetor buxheti 25.000.000 (njëzet e pesë milionë) lekë.

3. Në bazë të nenit 11, të VKM-së nr. 817, datë 28.12.2005, “Për miratimin e rregullores ‘Për procedurat dhe formën e njoftimit’”, ndryshimi i skemës ekzistuese njoftohet sipas formularit të thjeshtuar të njoftimit, kur skema e njoftuar parashikon rritjen e buxhetit të një

skeme të miratuar me më shumë se 20 për qind. Skema e njoftuar për vitet 2026–2028 është buxhetuar në vlerën prej 25 mln lekë në vit, në rritje me 38.8 për qind të ndihmës të autorizuar me vendimin e KNSH-së nr. 113, datë 11.12.2023, “Autorizim i ndihmës shtetërore ‘Mbështetje financiare (grant) për biznese të reja ‘të gjelbërta’, të cilat bazohen në një model eko-miqësor ose biznese ekzistuese të cilat tentojnë të shndërrohen në biznese ‘të gjelbërta’ duke futur elemente *go-green* në to””, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të neneve 17, 20, 22, dhe 31, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e pikës 4, të kreut II “Përshkrimi i masës”, të vendimit të KNSH-së nr. 99, datë datë 16.10.2020, “Autorizim i ndihmës shtetërore ‘Mbështetje financiare (grant) për biznese të reja ‘të gjelbërta’, të cilat bazohen në një model eko-miqësor ose biznese ekzistuese të cilat tentojnë të shndërrohen në biznese ‘të gjelbërta’, duke futur elemente *go-green* në to””, i ndryshuar në:

“*Kohëzgjatja*: Plani i ndihmës do të zbatohet në periudhën 2026–2028.”

2. Ky vendim të botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONI I NDIHMËS SHTETËRORE

Kryetar: Delina Ibrahimaj

Anëtarë: Mimoza Dhëmbi, Besnik Çina, Keida Qirko, Ahmet Mançellari